

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/343
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202200092/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i menjëherëshëm i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të IEVP-së në Berat.*

Drejtuar: **Z. Admir ABRIFA**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Artan LLANGO
Drejtor i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP)

BERAT

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020, datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim periodik në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Berat më datë 28.01.2022, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita dhe z. Besnik Deda, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Objektivi kryesor i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve në IEVP Berat, për garantimin e sigurisë, jetës, shëndetit dhe krijimin e ambienteve rekreative për të burgosurit që vuajnë dënimin në këtë institucion, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre; trajtimi dhe respektimi i të drejtave të të burgosurve në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim; kontrolli dhe administrimi i dokumentacionit që evidenton punën e kryer sipas sektorëve, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin e mëparshëm.

Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka të drejtën e detyrimit kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Shënime të përgjithshme

Inspektimi në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Berat, u zhvillua në kuadër të vizitave periodike monitoruese për vitin 2022, në institucionet penitenciare.

Grupi i inspektimit bazuar në metodologjinë e inspektimit në burgje, zhvilloi paraprakisht një takim me drejtorin e institucionit z.Artan Llango dhe shefin e policisë z.Syrja Malasi, të cilët u njohën me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, drejtuesit e institucionit informuan në lidhje me plotësimin e kushteve të jetesës për të burgosurit, ambientet e përbashkëta dhe aktivitetet që zhvillohen në institucion, masat e marra për trajtimin psiko-social dhe shëndetësor të të burgosurve nga sektorët përgjegjës, si dhe për zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së në inspektimin e mëparshëm.

Nga informacioni rezultoi se, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr.8927/1, datë 27.09.2018, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, i ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale IEVP-së Berat, është klasifikuar burg i sigurisë së zakonshme, me një seksion siguri të zakonshme dhe një seksion paraburgimi.

Organika e institucionit përbëhet nga 136 punonjës, prej të cilëve 25 punonjës ishin staf civil dhe 111 ishin punonjës me uniformë të sektorit të shërbimit të sigurisë të institucionit. Aktualisht organika e IEVP Berat, përbëhet nga sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve, sektori ligjor, sektori financiar, sektori i logjistikës, sektori shëndetësor dhe sektori i policisë. Në tërësi organika ishte plotësuar, por vereheshin mungesa në sektorin shëndetësor. **Ky sektor**, përbëhet nga 1 (një) mjek i përgjithshëm part-time, 5 (pesë) ndihmës mjekë, mungesë 1 (një) farmacist dhe 1 (një) stomatolog part-time.

Institucioni i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Berat, kishte një kapacitet maksimal 112 persona. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 143 persona, nga të cilët 34 persona të dënuar dhe 109 të paraburgosur. Në ditën e inspektimit, këtu ndodheshin 31 persona, më tepër se kapaciteti zyrtar.

Sikurse rezultoi nga raportimi, në këtë institucion **kishte mbipopullim mbi kapacitetin fizik** të përcaktuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë. Referuar statistikave, ky institucion ka patur mbipopullim edhe për periudhën Shtator deri në Janar 2022. Konkretisht:

- Shtator 151 persona ose 34%
- Tetor 144 persona ose 17 %
- Nëntor 146 persona ose 30%
- Dhjetor 139 persona ose 24%
- Janar 143 persona ose 27%

Sikurse e theksuam edhe më lart, një problem tjetër i evidentuar nga grupi i inspektimit, ishte mbipopullimi në dhomat e banimit (3-4 persona në një dhomë), si dhe tejkalimi i normës prej 4m² hapësirë jetike për person, e cila konsiderohet shkelje e standardit të sipërfaqes së banimit që duhet të disponojë një person i burgosur. ¹Shkelja e këtij standardi është evidentuar edhe nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) me rastin e vizitave

¹ Neni 3 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe neni 30 e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

monitoruese në Shqipëri, i cili në përfundim të vizitës ka rekomanduar autoriteteve Shqiptare se: “Të dënuarit/ paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo me pak se 22 m² në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10m² në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu, dhomat më të vogla se 6m² nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi”.

Godina në regjimin e brendshëm dhe infrastruktura e institucionit, ishin të përshtatura për të përballuar kapacitetin maksimal, si dhe dinamikën e lëvizjes së paraburgosurve, që ndryshon pothuajse çdo ditë.

Grupi i inspektimit, mori informacion edhe për situatën epidemiologjike të stafit dhe të të burgosurve të institucionit, për shkak të sëmundjes infektive COVID-19, si dhe masat e marra nga administrata e këtij institucioni për parandalimin e saj. Nga informacioni i dhënë nga sektori i shëndetësisë të institucionit dhe nga inspektimi, rezultoi se:

- Institucioni kishte rregullore të veçantë, ku parashikoheshin masat që duhet të zbatonin punonjësit dhe të burgosurit, për parandalimin e COVID-19, si dhe në rastet kur evidentoheshin si të prekur nga kjo sëmundje.
- Punonjësit e informacionit në hyrje të institucionit, kontrollonin matjen e temperaturës për çdo punonjës dhe vizitor, duke i evidentuar ato në një libër të veçantë. Pas kësaj procedure, stafi dhe vizitorët kalonin në një tunel dezinfektimi që ndodhej gjithashtu në hyrje të institucionit.
- Punonjësit e institucionit, zbatonin me korrektësi masat mbrojtëse dhe dezinfektuese, në ambientet e punës, si mbajtja e maskave, ruajtja e distancimit social dhe mbajtja e higjenes personale.
- Ishin minimizuar grumbullimet e stafit dhe të të burgosurve gjatë orarit të punës dhe zbatimit të orarit të veprimeve me të burgosurit.
- Masat parandaluese të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë, ishin të afishuara në hyrje të institucionit, në ambientet e regjimit të brendshëm dhe në çdo sektor banimi të të dënuarve dhe të paraburgosurve.
- Personeli shëndetësor i institucionit ushtronte kontrole për menaxhimin e gjendjes shëndetësore të dënuarve dhe të paraburgosurve, rezultatet e të cilave ishin të evidentuara në një libër të veçantë.
- Të burgosurit që për arsye shëndetësore kanë shkuar në spitalin rajonal Berat apo në klinika private sipas rekomandimit të mjekut, pas kthimit në institucion vazhdojnë të zbatojnë rregullat për karantinimin deri 10 ditë në sektorin e observimit, sipas protokollit shëndetësor.
- Për rastet e punonjësve apo të të burgosurve, që kanë rezultuar pozitiv (aktualisht nuk kishte asnjë rast) është bërë menjëherë hetimi epidemiologjik në bashkëpunim me strukturat e ISHP Berat. Të gjithë punonjësit e institucionit ishin të vaksinuar, ndërsa të burgosurit në masën 85% kishin përfunduar dhe dozën e dytë të vaksinës.
- Sipas një grafiku mujor, bëhej dezinfektimi i ambienteve në regjimin e brendshëm si të spitalit, dhomat e veçimit dhe në sektorin e observimit/karantinimit. Ndërsa dy herë në muaj, kryhet dezinfektimi për të gjithë ambientet e jashtme të institucionit.

Përsa i takon plotësimin të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i datës 13.12.2021², nga informacioni dhe evidentimi në vend i kushteve ku

² Dërguar rekomandimi nr. K/I17-2 prot, datë 13.12.2021 “Për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në IEVP-në Berat.

mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit, si dhe intervistat konfidenciale të zhvilluara me grupe e individë në këtë institucion, rezultoi:

- Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi për furnizimin me ujë të pijshëm 24 orë në ditë në ambientet e Institucionit të IEVP-së Berat, dhe deri në realizimin e plotë të investimit të rritet numri i orareve të furnizimit me ujë në 10 orë në ditë nga 4 orë që janë aktualisht. Ishte shtuar furnizimi me ujë të pijshëm nga 4 orë që ka qenë në 8 orë aktualisht.
- Ishte zbatuar rekomandimi, për plotësimin me orenditë e nevojshme për jetesë në dhomat e banimit të të dënuarve/paraburgosurve si tavolina, karrige dhe dollapë për mbajtjen e sendeve personale.
- Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi, për përmirësimin e cilësisë së ushqimit **por jo** larmishmërinë e tij, sipas produkteve të stinës, si dhe ushtrimin e kontrolleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit për këtë problematikë.
- Ishte zbatuar rekomandimi, për sigurimin e plotë dhe furnizimin me medikamente, për rastet e të sëmurëve akutë dhe rastet e emergjencave.
- Ishte zbatuar rekomandimi, për pajisjen e të dënuarve dhe të paraburgosurve me detergjentë dhe materiale të tjera për pastrimin dhe mbajtjen e higjienës personale dhe të ambientit në dhomat e banimit, sipas normativave mujore.
- Ishte zbatuar rekomandimi, për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomës së observim/veçimit.
- Ishte zbatuar rekomandimi, për të vendosur në ambientet e kuzhinës, pajisjen për aspirimin dhe ventilimin e ajrit.
- Ishte zbatuar rekomandimi, për shtimin e numrit të vaksinimeve të burgosurve dhe promovimin e këtij procesi nëpërmjet materialeve informuese për zbatimin e protokollit shëndetësor për parandalimin e kësaj sëmundje dhe ruajtjen e distancës fizike mes njëri-tjetrit.

Ndërkohë, që një pjesë e rekomandimeve të mëparëshme të paraqitura nga Avokati i Popullit, nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar.

Më konkretisht:

- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për të garantuar akomodimin e të dënuarve dhe të të paraburgosurve në mjedise të përshtatshme banimi, duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6m² për dhomat për një person dhe 4m² për person, kur në to sistemohen më shumë banorë.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për plotësimin e organikës së stafit mjekësor të institucionit me mjek të përgjithshëm, farmacistë, stomatolog, të punësuar me kohë të plotë.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për rritjen e pranisë së punonjësve të sektorit juridik në kontakte të përditëshme me personat që vuajnë dënimin në këtë institucion, për dhënien e këshillimeve ligjore dhe sqarimet për zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave që ata mund të paraqesin.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për pajisjen e institucionit me autoambulancë, për transportin e të sëmurëve në rastet e emergjencave shëndetësore.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për hapjen e njësisë tregtare për ofrimin e produkteve bazë të domosdoshme për të dënuarit dhe të paraburgosurit në IEVP Berat.

- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për instalimin e një skaneri në ambjentet e IEVP Berat për të bërë të mundur kontrollin me efikasitet të ushqimeve për të dënuarit dhe të paraburgosurit.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për rritjen e aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale nga sektori psiko-social, me pjesmarrjen e gjerë të personave të burgosur, që të ndikojnë në formimin dhe riintegrimin e këtyre personave.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për mobilimin me orenditë e nevojshme dhe pajisjen me materiale informuese për të mundësuar realizimin e takimeve mes të dënuarve dhe fëmijëve të mitur të tyre në kuadrin e garantimit të prindërimit në distancë.

Grupi i inspektimit në vijim të punës, vizitoi mjediset në regjimin e brendshëm të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Berat, u njoh me regjistrat dhe dokumentacionin e disa praktikave që kanë të bëjnë me të drejtat e të burgosurve, si dhe zhvilloi intervista në mënyrë konfidenciale me të dënuarit/paraburgosurit në dhomat e tyre.

Në përfundim, grupi i inspektimit administroi gjithashtu kopje të dokumentacionit, të disa praktikave sipas sektorëve, konkretisht:

- Organikën e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Berat;
- Raport Incideti;
- Vendim nr.3377 datë 08.09.2021, për miratimin e listës të punësimit;
- Listë apelit sipas godinës;
- Fotokopje të regjistrat kërkesë/ankesave;
- Plani vjetore i aktiviteteve nr.63 prot, datë 07.01.2021;
- Lista e të dënuarëve të shëndetit mendor;
- Raport shërbimi;
- Vendimi për dhënien e masës disiplinore;
- Dosje psiko-sociale;
- Libri i pritjes së të dënuarëve ose të paraburgosurve;
- Vlerësim sjellje për periudhën 6- mujore;

Trajtimi

Grupi i inspektimit mori informacion nga drejtuesit e institucionit dhe zhvilloi intervista konfidenciale me të burgosurit, në lidhje me trajtimin e këtyre personave nga stafi i institucionit, me qëllim identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesë/ankesave të të burgosurve, procedurat që ndiqen nga komisioni për pritjen e tyre në institucion, komisioni për dhënien e masave disiplinore, aktivitetet e zhvilluara, trajtimin shëndetësor të të dënuarve, cilësia e ushqimit, furnizimi sipas normativave me detergjentë dhe mjete të higjenës personale, etj.

Nga informacioni dhe në intervistat konfidenciale të zhvilluara me të paraburgosurit dhe të dënuarit rezultoi se, nuk kishte raste torture, të dhunimit fizik ose psikologjik apo përdorimit të tepruar të forcës fizike ndaj këtyre personave, nga personeli i sigurisë së shërbimit të policisë apo punonjësit e stafit civil që shërbejnë në këtë institucion.

Godinat dhe ambjentet e dhomave të banimit në regjimin e brendshëm, ishin në gjendje **jo të mirë teknike**. Sektori i paraburgimit është i ndarë në godinë më vete nga sektorët e të

dënuarve, të cilët janë akomoduar në 2(dy) godina, 3 kateshë të ndara në sektorë, por **lagështira ishte evidente në gjithë godinën e IEVP-së, dhe më e theksuar ishte në ambientin e tualeteve në këtë institucion.** Niveli i lagështirës ishte tej normave të lejuara dhe për pasojë prezenca e saj në këto ambiente, ndikon drejtëpërdrejt në jetën dhe shëndetin e të paraburgosurve si dhe për vetë punonjësit e policisë së burgut. Kjo problematikë është më e mprehtë po të konsiderohet edhe situata e pandemisë e cila ndikon në kushtet e përgjithshme të shëndetit të paraburgosurve.

Por, gjatë intervistave të dënuarit/paraburgosurit ata ngritën ankesa që kishin të bënin me hapësirën e vogël të dhomave të banimit, duke patur parasysh faktin që, në dhoma ishin të akomoduar 3-4 persona. Hapësirat dhe sipërfaqet e dhomave nuk i përgjigjeshin standardit për normativën që ato duhet të plotësonin për një person, ashtu siç është e sanksionuar në aktet ligjore e nënligjore dhe në aktet ndërkombëtare, për këtë qëllim.

Grupi i inspektimit, në intervistat me të paraburgosurit evidentoi si shqetësimin kryesor përkeqësimin e kushteve të jetesës në disa dhoma banimi, për shkak të mbipopullimit të tyre mbi kapacitetin fizik që ato kanë, si dhe mundësinë e shtimit të numrit të takimeve fizike mujore me familjarët.

Nga intervistat konfidenciale të zhvilluara me të burgosurit, rezultoi se kishte disa ankesa që ishin të lidhura kryesisht me kushtet e përgjithshme të jetesës në institucion. Ato konsistojnë në prezencën e lagështirës në disa dhoma banimi dhe kryesisht në ambientet e përbashkëta si në tualete dhe dushe; problemet me sistemin elektrik dhe mungesën e sistemit qendror për ngrohje/ftohje, për t'iu përshtatur kushteve klimaterike; mungesën e ujit të ngrohtë për larjen e trupit; etj.

Personat e moshës 18-21 vjeç **nuk** ishin të akomoduar në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këta persona, por ata ishin të shpërndarë në dhoma me të burgosurit e tjerë. Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, sistemimi i tyre në dhoma të veçanta, ishte i pamundur për shkak të mospërshtatjes dhe familjarizimit që ata kishin me të burgosurit e tjerë. Ajrimi dhe veprimtaritë me karakter sportiv dhe edukativ, për shkak të situatës të pandemisë, vijonin të zhvilloheshin me grupe të vogla dhe të ndarë sipas grup moshave dhe interesave të të burgosurve, ku nuk justifikohet shkeljen e rregullorës³

Në intervistat me të burgosurit, ata ngritën si shqetësim mungesën e takimeve fizike me familjarët e tyre, pasi për shkak të pandemisë kanë kaluar kohë pa u takuar me prindërit dhe fëmijët e tyre. Ndërsa, komunikimi në telefon/skype me familjet, nuk ishte ndërprerë në asnjë kohë.

Gjithashtu, të intervistuarit ngritën me shqetësim problematikën, që kishte të bënte me ushqimin, jo në drejtim të cilësisë së gatimit, por në drejtim të larmisë së vakteve.

Po ashtu, kishte ankesa dhe pretendime lidhur me kohëzgjatjen dhe zvarritjen e proceseve gjyqësore. Në lidhje me këto ankesa, të intervistuarve ju bë me dije nga grupi i inspektimit se, pavarësisht se këto ankesa nuk janë në juridiksionin dhe kompetencën e Institucionit të Avokatit të Popullit, ato do t'ju adresohen nga ana jonë autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe organeve të larta të drejtësisë.

³ Në nenin 17 të "Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve", përcakton se të rinjtë e moshës nga 18 deri 21 vjeç, që akuzohen për kryerjen e një veprë penale, kur kanë qenë të mitur, mbahen në seksione të veçanta nga të burgosurit e tjerë të rritur.

Në intervistat me të burgosurit, u ngrit si shqetësim mungesa në organikë e një mjeku me kohë të plotë, për shkak të nevojës që ata kishin për kryerjen në kohë të vizitave mjekësore apo lëshimit të rekomandimeve për vizita mjekësore pranë mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Berat. Mjeku që kryente detyrën në këtë institucion, nuk ishte me kohë të plotë, por ishte i punësuar me kontratë me kohë të pjesshme konkretish nga ora 13:00 deri në orën 16:00 të çdo ditë të javës, dhe koha për të kryer vizita mjekësore nuk ishte e mjaftueshme, pasi numri i kërkesave të të burgosurve për vizita mjekësore, ishte i lartë.

Koha në dispozicion për vizitat mjekësore nga mjeku, ishte në varësi të numrit të kërkesave dhe diagnozës që paraqisnin të burgosurit dhe kryheshin brenda ditës ose maksimumi brenda 2 ditëve. Ndërsa, vizitat mjekësore pranë mjekëve specialistë në Spitalin Rajonal të Beratit, në bazë të rekomandimit të mjekut të institucionit, kryheshin në varësi të garantimit të masave të sigurisë për lëvizjen e të sëmurëve nga I EVP për në spital, si dhe zbatimit të protokollit shëndetësor të COVID-19, mundësisht menjëherë për rastet urgjente ose brenda një jave.

Në lidhje me stafin e institucionit, të burgosurit ngritën si shqetësim mungesën e prezencës së stafit të mjaftueshëm në sektorin juridik. Të burgosurit paraqisnin ankesa për punonjësit e këtij sektori në lidhje me nevojën që ata kishin për trajtime të kërkesave të tyre. Po ashtu dhe për vonesa në marrjen në kohë të kërkesë/ankesave të të burgosurve drejtuar drejtorit të institucionit, si dhe institucioneve të tjera qëndrore e të pavarura. Të burgosurit ngritën me shqetësim një problem që kishte të bënte me mos vënien në dispozicion të korrespondencës me kthim përgjigje me shkrim që vinin në emrin e tyre nga DPB-ja dhe institucionet e tjera të pavarura, duke ju mohuar të drejtën e ankimit, pasi në shumicën e rasteve ankesat e tyre nuk merreshin në shqyrtim, për shkak të mosrespektimit të afateve nga ankuesit. Në këtë drejtim, grupi i inspektimit kërkoi regjistrin ku evidentohet një praktikë e tillë, por punonjësit e sektorit psiko-social e justifikonin me faktin se shkresat ju dorëzoheshin nominalisht çdo ankuesi, pa një dokument që vërtetonte marrjen në dorëzim të shkresave me përgjigje që hynin në institucion në emër të të burgosurve. Ata shtruan nevojën e kontakteve më të shpeshta me juristët në lidhje me përditësimin e informacionit për ecurinë dhe zgjidhjen e ankesave drejtuar drejtorit të institucionit, si dhe për dhënien e ndihmës juridike për çështje që lidhen me veprën penale të kryer nga ana e tyre. Për këtë çështje Avokati i Popullit ka bërë rekomandime⁴ “Për zbatimin me korrektesë të dispozitave ligjore lidhur me njoftimin e vendimit të gjykatës, të burgosurit në vendin e burgimit, si dhe shënimin në dispozitivin e vendimit të afatit të ankimit, gjykatës ku duhet të paraqitet ankimi dhe përlllogaritjes së afatit”.

Në vijim të ankesave, të burgosurit nuk kishin shqetësime për aktivitetet kulturore dhe sportive me pjesëmarrje të gjerë të tyre, pasi ato zhvilloheshin çdo ditë, por ngritën si shqetësim orare më të zgjatura të këtyre aktiviteteve, duke pohuar se angazhimi i tyre gjatë gjithë ditës do të krijojë një gjendje të mirë psikologjike. Aktivitetet që zhvilloheshin ishin orari i ajrimit, lojrat e tavolinës, zhvillime të aktivitetit të sportit futbollit çdo ditë midis sektoreve, rritja e temave sociale, vazhdimi i kurseve profesionale elektrik dhe hidraulik, koncert muzikor me këngë shqiptare dhe të huaja, mbështetur nga shkolla artistike “Ajet

⁴<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20drejtuar%20Gjykes%20Elbasan%20lidhur%20me%20njoftimin%20dhe%20permbajtjen%20e%20dispozitivit%20e%20vendimit%20penal.pdf>

Xhindole”, etj. të cilat ishin të pamjaftueshme në arritjen e qëllimit për ruajtjen e shëndetit mendor dhe më pas rehabilitimin e kësaj kategorie.

Në këtë aspekt, për sa u përket aktiviteteve social-edukuese, sportive dhe kulturore për këtë periudhë, të burgosurit kërkonin vetëm zgjatjen e orarit të hapjes së klasave të edukimit, sipas sektorëve gjatë kohës së mbasditeve për zhvillimin e lojrave të ndryshme me grupe, si dhe kompletimin me pajisjet e nevojshme të ambientit të palestrave në çdo sektor për tu ushtruar fizikisht, me qëllim kalimin e kohës së lirë dhe uljen e nivelit të stresit.

Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, u evidentua gjithashtu dhe problemi i sistemit për ngrohje/ftohje i dhomave të banimit dhe furnizimin me ujë të ngrohtë i dusheve. Sistemi i ngrohjes në tërësi është funksional, por sistemi i “çillerave” ka shfaqur probleme teknike që në fillimin e punës së këtij institucioni. Sipas informacionit, sistemit të ngrohjes i mungonte edhe termoizolimi i tubacioneve që lidhin kaldajën qendrore me godinat e banimit, të cilat janë të ekspozuara ndaj kushteve atmosferike, duke mos e munduruar furnizimin rregullisht të këtyre ambienteve me sasi të mjaftueshme të ngrohjes dhe rrjedhimisht edhe me ujin e ngrohtë për larjen e trupit të të burgosurve.

Këto janë investime të munguara që në fazën e zbatimit të projektit për ndërtimin e kësaj IEVP-je, ndaj për kryerjen e këtyre investimeve dhe mirëmbajtjen në tërësi të godinave, kërkohej domosdoshmërisht të planifikohen fonde në buxhetin e këtij institucioni.

Institucioni i Avokatit të Popullit, konstaton neglizhencë nga ana e drejtuesve të IEVP Berat, për evidentimin e problematikave që kërkojnë investim dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të përmbushur detyrimet ligjore të nevojshme dhe gjetjen e fondeve përkatëse për të munduruar krijimin e kushteve të përshtatshme infrastrukturore, si dhe në sigurimin e bazës materiale të nevojshme për të garantuar respektimin e të drejtave ligjore ndaj të paraburgosurve dhe të dënuarve që trajtohen në këtë institucion.

Grupi monitorues inspektoi situatën e trajtimit, kushteve materiale dhe ato higjienike të burgosurve në ambientet e observim/veçimit. Ky ambient përbëhej nga 2 dhoma observimi dhe 3 dhoma veçimi. Në ditën e inspektimit në ambientin e observimit u konstatua se, njëra dhomë ishte pajisur me një krevat, dyshek, batanie si dhe çarçaf ndërsa tjetra ishte pajisur vetëm me krevat, ku mungonin dysheku, batania, çarçafet etj. Ndërsa në ambientin e veçimit ndodhej vetëm një person, në pritje të zhvillimit të mbledhjes së komisionit të disiplinës së institucionit, për dhënie të masës disiplinore. Ambienti në tërësi ishte i lyster dhe ishte i pastër nga ana higjieno-sanitare. Në dhomat e veçimit mungonin pajisjet e domosdoshme për të përmbushur nevojat kryesore të jetesës, si tavolina, stola, komodina. Problematike në këto ambiente ishte gjithashtu dhe mungesa e dushit për larjen e trupit të personave, pasi në mungesë të tij, larja e trupit duhet të bëhej në ambientet dusheve të përbashkëta sipas sektorëve.

Dhomat e banimit të të burgosurve, kishin tualete dhe lavamanë brenda në dhoma. Veç tyre, në çdo sektor kishte ambiente të përbashkëta që shërbenin si tualete dhe dushe për larjen e trupit.

Masat mbrojtëse.

Në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe stafin e institucionit, u kërkua informacion për sistemin e kërkesë/ankesave, ku rezultoi se sistemi funksiononte sipas urdhërit të

Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve⁵. Në urdhër, përcaktohen personat përgjegjës të autorizuar të cilët në mënyrë periodike marrin kërkesë/ankesat e të dënuarve/paraburgosurve, kryejnë regjistrimin në regjistrin përkatës, protokollimin e tyre, si dhe trajtimin dhe kthimin e përgjigjes brenda afatit të përcaktuar nga titullari i institucionit⁶. Ky regjistër ruhet dhe administrohet nga sekretaria e institucionit.

Të paraburgosurit/dënuarit pasi plotësonin një formular kërkesë/ankese ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social, sipas sektorëve që mbulonin. Më tej, punonjësi i edukimit, kërkesë/ankesat e të burgosurve brenda ditës i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili nëpërmjet sektorëve përgjegjës, kthente përgjigje në kohë sa më të shpejt. Në çdo rast mungonte evidentimi i marrjes dijeni të shkresave⁷.

Nga verifikimi i regjistrit, objekti i kërkesave të të burgosurve kishte të bënte me kërkesa për blerje TV, biseda në SKYPE me familjen, aplikim për hapje llogarie në bankë, mungesa të medikamenteve mjekësore, pajisjen me kopje të vendimit të gjykatave, konsulenca juridike, etj.

Grupi i inspektimit, kërkoi informacion edhe lidhur me procedurat e ndjekura për hyrjet e reja në institucion, ngritjen dhe funksionimin e komisionit të pritjes, si dhe mënyrën e plotësimit të regjistrit dhe dosjeve personale të të burgosurve. Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se, procedura e pranimit të të burgosurve që hyjnë rishtas në institucion zbatohet në mënyrë korrekte nga komisioni i pritjes, e cila regjistrohet në regjistrin përkatës dhe më tej protokollohet në sekretarinë e institucionit.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Mbulimi me kamera në IEVP Berat, të cilat monitoronin ambientet në regjimin e brendshëm, si dhe mjediset e jashtme të institucionit përgjatë 24 orëve. Të dhënat nga regjistrimet e kamerave ruhen në server për një periudhë 30 ditore.

Komunikimet me telefon me familjet e tyre, të burgosurit i zhvillonin normalisht në telefonat me kartë të vendosur në mjediset e korridoreve në regjimin e brendshëm. Ata ishin në gjendje pune dhe të burgosurit kryenin 8 telefonata në muaj me familjet dhe të afërmit e tyre. Sa i takon komunikimet me telefon me institucionin e Avokatit të Popullit, të burgosurit ngritën shqetësimin se nuk mund të flisnin lirisht, pasi numrat e telefonit të institucionit nuk ishin të lidhur drejtëpërdrejt pa kartë dhe pa pagesë nga kompania që ofronte këtë shërbim.

Gjithashtu, në lidhje me sistemin e aparateve të telefonave, ngelet problematik fakti që në sistemin e burgjeve aktualisht operon vetëm një kompani telefonike nga dy kompani që kanë funksionuar rregullisht, gjë e cila ka sjellë për pasojë zvogëlimin e numrit të aparateve në gjendje pune dhe uljen e minutazhit të kartave telefonike, shqetësim ky i ngritur në intervistat me të burgosurit edhe në IEVP-të e tjera.

⁵Neni 58, pika 5 e ligjit Nr.81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

⁶Neni 58 i ligjit Nr.81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

⁷ Në nenin 34 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve përcakton se: i burgosuri ka të drejtë të paraqesë kërkesë ose ankesë sipas përcaktimeve të bëra në legjisllacionin për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve.

Ambienti i takimeve të të burgosurve me familjarët në I EVP Berat, kishte 4 poste për takime online, 2 poste për takime fizike me familjarët e të dënuarve, 1 post për takime për të paraburgosurit, 1 dhomë prindërimi në distancë dhe 1 dhomë për takime speciale me familjarët. Nga intervistat, rezultoi se të burgosurit zhvillonin një takim fizik dhe tre takime online me familjarët e tyre, për të cilat nuk kishin ankesa në lidhje me planifikimin dhe kohëzgjatjen e orarit të takimeve⁸.

Një dhomë e prindërimit në distancë, ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige, ku të burgosurit mundet të takonin fizikisht fëmijët e tyre. Gjatë takimeve me fëmijët dhe familjarët në këto dhoma, respektoheshin masat e sigurisë por dhe privatësia e takimit.

Në ambientin e takimeve ishte krijuar një mjedis i veçantë për të burgosurit që kishin fëmijë të vegjël, lidhur me ushtrimin e të drejtës së prindërimit në distancë. Ata mund të takoheshin në këtë ambient pa barriera apo kufizime fizike, por dhoma kishte nevojë për investime dhe pajisje me orendi për të qenë e përshtatshme për këtë qëllim.

Në I EVP Berat, të dënuarit dhe të paraburgosurit ngriten si shqetësim mënyrën e kryerjes së kontrollit të ushqimeve nga institucioni. Evidentohet se në I EVP Berat kishte nevojë për instalimin e një skaneri, për të bërë të mundur kontrollin me efikasitet të ushqimeve.

Në I EVP Berat ishin të punësuar 16 të dënuar/paraburgosur, nga 14 që ishin të miratuar sipas strukturës organike, në pozicione pune si sanitarë, ndihmës kuzhiner, shpërndarës ushqimi, bojaxhi, lavaxhi, lulishtar etj, pasi institucioni kishte një numër të madh të ambienteve që ndodhen në regjimin e brendshëm të këtij institucioni. Sipas intervistave me të burgosurit, punësimi paraqet interesim për sa kohë kushtet e punësimit dhe shpërblimi janë të rregulluar me aktet nënligjore, sikurse parashikohet në nenet 43 dhe 44 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Së fundmi, me miratimin e Vendimit nr. 602, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj” , i cili është botuar në F.Z. nr. 161, datë 15.10.2021, pritet edhe zgjidhja e kësaj problematike.

Kushtet materiale.

I EVP Berat është një institucion i ri të ndërtuar në vitin 2007, me infrastrukturë të plotë e funksionale në regjimin e jashtëm dhe të brendshëm të tij, sipas të gjitha standardeve të përcaktuara në dispozitat ligjore, nënligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim. Kushtet materiale të institucionit në funksion të të burgosurve, ishin të plotësuara dhe garantonin standarde të mira për jetesë normale dhe zhvillimin e aktiviteteve me karakter kulturor, edukativ dhe sportiv, për rehabilitimin e kësaj kategorie, me përjashtim të disa çështjeve të

⁸ Referuar Vendimit, nr.207 datë 06.4.2022 “Për Miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, në nenin 70 përcakton se “Të burgosurit kanë të drejtën e zhvillimit të vizitës të paktën 4 (katër) herë në muaj me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, me një kohëzgjatje të paktën 1 (një) orë. Kur organizimi i institucionit e lejon, i burgosuri mund të autorizohet të qëndrojë me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes përtej kufirit kohor të parashikuar”, dhe në piken 12 të nenit 68 thuhet se “në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësive natyrore, nevojave të sigurisë apo me kërkesë të të burgosurit, vizitat fizike mund të zëvendësohen me takimet virtuale nëpërmjet platformave të komunikimit online të instaluar në institucionet përkatëse të ekzekutimit të vendimeve penale”.

trajtuara më lart për sistemin ngrohje-ftohjes, lagështirës dhe mbipopulimit dhe çështjes të mirëmbajtjes së vazhdueshme.

Grupi i inspektimit inspektoi plotësimin e kushteve në ambientet e regjimit të brendshëm të institucionit, sipas kërkesave ligjore dhe në respektim të standardeve më të mira për jetesë dhe aktivitete të të burgosurveve.

Godina kryesore në regjimin e brendshëm të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale të IEVP-së, Berat, përbëhej nga dy godina tre katëshe, me 40 dhoma në total. Nisur nga infrastruktura e brendshme, në katin e parë ndodhen ambientet e përbashkëta për takime me familjarët, kuzhina, lavanderia. Ndërsa në katin e dytë ndodheshin salla tv, palestra, biblioteka, ambientet e kultit fetar, tualete të përbashkëta të këtyre ambienteve.

Ambientet në regjimin e brendshëm ishin sipas standardeve përse i përket llojshmërisë, si klasat e edukimit dhe për këshillimin psiko-social në cdo sektor, dhomat për takimet me familjarët, dhomat e prindërimit në distancë, klasat ku zhvillohej mësimi dhe për kurset profesionale, biblioteka, ambiente kulti të ndara më vete për besimtarët mysliman dhe të krishterë, etj. Në këto ambiente, ndodheshin dhe sallat e forcës, palestra e cila kishte mungesë të veglave që shërbejnë për këtë qëllim, pavarësisht rekomandimeve të vazhdueshme të Avokatit të Popullit e veçanërisht për shkak të situatës së vështirë psikologjike të ardhur nga COVID-19.

Në dhomat e banimit akomodohen 3 deri 4 persona. Kushtet e dhomave, sipërfaqet dhe hapësirat ishin të përshtatura duke respektuar hapësirën jetike për person. Pothuajse të gjitha dhomat kishin tualete brenda, të cilat ishin në kushte të pastra higjieno-sanitare. Dhomat ishin të pajisura me orenditë e nevojshme për mbajtjen e sendeve personale dhe ruajtjen e ushqimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve, por sikurse rezultoi në shumicën e rasteve këto orendi e pajisje ishin siguruar nga familjarët e tyre. Materialet për fjetje si dyshekët, batanijet dhe çarçafët ishin në gjendje të mirë dhe të mirëmbajtura.

Dritaret mundësonin ndriçim natyral të bollshëm. Në dhoma sigurohej energji elektrike për ndriçim dhe nevoja të përditshmërisë. Çdo dhomë banimi kishte tualet më vete. Por, kishte mungesë të detergjenteve për ruajtjen e higjenës vetjake të burgosurveve pavarësisht se ishte shpërndarë sipas normativës mujore, ishte pamjaftueshme për larje, përbënin arsye që në dhomat e banimit të mungonte pastërtia higjieno-sanitare. Ambientet e përbashkëta të dusheve për larjen e trupit ishin funksionale për çdo sektor.

Në koridoret e regjimit të brendshëm kishte stola të cilët përdorehin për raste festash apo aktivitete nga të dënuarit/paraburgosurit. Gjithashtu, këto koridore ishin të pajisura me kabina telefonike të cilat mund të përdorehin nga të dënuarit. Në regjimin e brendshëm të çdo godine kishte dhoma këshillimi të cilat ishin funksionale.

Ambientet në regjimin e brendshëm kishin energji elektrike të pandërprerë që furnizohej nga rrjeti elektrik, por kishte dhe burim energjie rezervë me gjenerator, për furnizimin me energji elektrike në rast ndërprerje.

Furnizimi me ujë kryhej nga rrjeti i ujësjellësit të qytetit në Berat dhe furnizonin depon e e cila furnizonte institucionin deri në 10 orë ujë. Ambientet e brendshme, furnizoheshin me ujë sipas orareve të miratuara nga titullari i institucionit, për mbajtjen e higjenës personale, për larjen e trupit dhe ruajtjen e pastërtisë në ambientet e përbashkëta.

Në dy godinat e I EVP Berat kishte 5 (pesë) ndarje ajrimi, 1 (një) fushë futbollit dhe 1 (një) fushë volejbollit. Grupi i inspektimit konstatoi se në mjediset e jashtme, që përdoren për ajrim, të dënuarit dilnin me orare të cilat varionin nga 2 orë deri në 3 orë. Nga intervistat u konstatua se të paraburgosurit dhe të dënuarit lejoheshin të dilnin në ajrim të ndarë dhe në orare të ndryshme dhe se nuk kishin pasur probleme në këtë drejtim.

Gjithashtu kishte ambiente për aktivitete këshilluese, fetare, kulturore, sportive etj. Biblioteka konsistonte në një dhomë me disa rafta të vendosura në mur dhe një tavolinë të madhe plotësuar me karrige. Në bibliotekë kishte më tepër se 700 tituj librash. Ambientet e kultit ishin të ndara sipas përkatësisë fetare në mysliman dhe të krishterë.

Në I EVP Berat, funksiononte normalisht lavanderia, tashmë të 5 lavatriçet dhe tharësja e rrobave ishin në punë, ku të dënuarit dhe të paraburgosurit merrnin shërbim pa vështirësi.

Ushqimi për të dënuarit dhe të paraburgosurit gatuhej në kuzhinën e institucionit, e cila ishte me hapësirë e sipërfaqe të madhe, si dhe me ambiente më vete për gatimin e ushqimit dhe për ruajtjen e tij. Kuzhina ishte e kompletuar me pajisje frigoriferike për secilin produkt ushqimor më vete, me pajisje kuzhine alternative (elektrike dhe gaz) për gatimin e vakteve ushqimore, si dhe me karroca dhe vaska nikelato për shpërndarjen e ushqimit deri te të burgosurit, të cilat ishin të reja dhe të një cilësie shumë të mirë.

Në kuzhinë ndodhej e afishuar kuota ditore, menyja, si dhe librezat shëndetësore të personelit të kuzhinës. Ndërsa, kampionët e ushqimit për secilin vakt ushqimor ruheshin në kushte frigoriferike. Gatimi i ushqimit kryhej sipas kategorive të përcaktuara në rregulloren e brendshme të burgjeve më vete për të burgosurit, për të punësuarit, si dhe për të sëmurët diabetik. Personeli i kuzhinës përbëhej nga 4 kuzhiner sipas strukturës organike dhe 1 ndihmës kuzhiner, të punësuar nga të dënuarit/paraburgosurit. Në intervistat me të dënuarit dhe të paraburgosurit, nuk u paraqitën ankesa lidhur me cilësinë e gatimit dhe shpërndarjen e ushqimit, por ata kishin pretendime për larmishmërinë e tij. Larmishmëria është si rezultat i normave të ulëta të ushqimit ditor, të përcaktuara në urdhërin e përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.⁹

Regjimi dhe aktivitetet.

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale ishte i afishuar. Në ambientet e I EVP-së ishin të afishuara posterat e Avokatit të Popullit, ku specifikoheshin të drejtat e të paraburgosurve dhe të dënuarve, gjithashtu edhe numrat e kontaktit. Nga bisedat me të paraburgosurit, grupi i inspektimit mori informacionin se ajrimi ishte një aktivitet që kryhej sipas parashikimeve ligjore.

Gjatë inspektimit u vu re se zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta, duke respektuar dhe rregullat e vendosura nga Ministria e Shëndetësisë për shkak të masave për mospërhapjen e sëmundjes infektive COVID-19. Shumë prej të intervistuarve, kërkuan të kenë më shumë orare të zgjatura në aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive, si dhe më shumë mjete dhe pajisje sportive, me qëllim shtimin e aktiviteteve edukative, social-kulturore dhe sportive

⁹ Urdhër i përbashkët i Ministrisë të Drejtësisë nr.104/5 prot., datë 19.07.2006 dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.205/3 prot., datë 27.07.2006 "Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit".

për rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve. Në këtë kuadër kërkohet një bashkëpunim më i mirë me organizatat jofitimprurëse, duke respektuar masat e parashikuara në protokollin shëndetësor për parandalimin e COVID-19 në këtë institucion.

Gjatë inspektimit u vu re se zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta nga të cilat mund të përfitonin të paraburgosurit, të cilat ishin kryesisht, lojërat e tavolinës siç janë lojëra me letra, domino, aktivitetet fetare, futboll, trajtimi periodik i temave sociale nga specialistët e edukimit në sektorin përkatës. Temat sociale janë realizuar në klasat e këshillimit duke krijuar fokus grupe me kategori të ndryshme me të paraburgosur dhe të dënuar, për ti ardhur në ndihmë rehabilitimit sa më shpejt në kushtet e privimit nga liria. Në ambientet e regjimit të brendshëm nga sektori i edukimit realizohet plani ditor i aktiviteteve ku realizohen aktivitete sportive si futboll në kalçeto dhe palestër. Në ambientet e palestrës sipas planit të aktivitetit ditor zhvillojnë palestër një orë në ditë. Në lidhje me këtë, të paraburgosurit ngritën si shqetësim mungesën e materialeve në palestër si psh. gira në çdo rast, shtaga të ndryshme sipas peshave, shtrimin me tapet, etj.

Në IEVP Berat, në mënyrë të vazhdueshme janë zhvilluar kurset profesionale për elektrikist dhe hidraulik. Në këto kurse marrin pjesë të burgosurit të cilët i frekuentojnë rregullisht dhe në përfundim të kursit pajisen me certifikatë pjesëmarrje. Aktualisht këto kurse zhvillohen çdo ditë sipas një programi të përcaktuar dhe kishte nga 8 të burgosur për secilin kurs.

Është për t'u theksuar se një ndër qëllimet primare të institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave, në momentin që do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se *“Regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*¹⁰.

Në IEVP-në Berat, të dënuarit dhe të paraburgosurit, praktikanteve e riteve të feve islame dhe krishterë kryenin ritet fetare në mënyrë të rregullt.

Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuar me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit dhe të paraburgosurit, me programet individuale dhe në grup, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

Shërbimi Shëndetësor.

Grupi i inspektimit, gjatë vizitës inspektuese në IEVP Berat, i kushtoi një rëndësi të veçantë funksionimit dhe cilësisë së ofrimit të shërbimit shëndetësor të të paraburgosurve, për garantimin dhe ruajtjen e shëndetit të këtyre personave që vuajnë dënimin në regjimin e burgjeve, si dhe i krahasuar me standardet e përcaktuara në aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Organika e stafit mjekësor në këtë institucion përbëhej nga një mjek (ishte emëruar part-time), katër ndihmës mjekë, stomatolog dhe një farmacist në mungesë.

Mekanizmi Kombëtar konstaton se mungesa e stomatologut e farmacistit si dhe e mjekut me kohë të plotë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor

¹⁰Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit, pasi mund të ketë raste urgjente të cilat personeli shëndetësor nuk mund t'i përballojë dhe pasojat mund të jenë të rënda.

Në të njëjtën kohë, fakti që mjeku punonte me kohë të pjesëshme dhe është i pranishëm në këtë institucion vetëm pjesërisht gjatë ditës, përbën cënim të standardeve të kujdesit shëndetësor. *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet t’u mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.*

Gjatë inspektimit u evidentua se institucioni kishte marrë masa për kompletimin e dhomës së stomatologut dhe ishte e pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme, kishte dhomë mjeku, farmacisti dhe infermierie të pajisura me orendi sipas standardeve. Dhoma e vizitave ishte e pajisur me një shtrat vizitash, si dhe një tavolinë dhe një karrige. Dhoma shtrimi ishin tre, të pajisura me nga 2 (dy) shtretër, por kishte mungesë pajisje të një aparat oksigjeni. Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti ai i mjekut, u konstatua ekzistenca e një regjistri të vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve dhe kartelave mjekësore, të cilat ishin mbajtur në rregull. Ndërkohë konstatuam se nga ana e stafit mjekësor ishin marrë masat për pajisjen e sektorit të shëndetësisë me një libër për regjistrimin e rasteve të veçanta dhe të dhunës. Skema e rimbursimit të ilaçeve në parim ishte në funksionon dhe të paraburgosurit/dënuarit ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Skema e rimbursimit të ilaçeve funksiononte mirë për të dënuarit, sipas kontratës trepalëshe me FSDKSH dhe depon farmaceutike, sigurimi me ilaçe në institucion. Ndërkohë, që më i vështirë bëhej zbatimi i kësaj skeme për të paraburgosurit, të cilët për shkak të vonësive në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve personale e kishin më të vështirë sigurimin e ilaçeve me anë të skemës së rimbursimit të ilaçeve. Gjithashtu, nga të intervistuarit u ngritën ankesa në lidhje me mungesën e medikamenteve në institucion, të cilat shpesh mbulohehin me kontributet e sjelljes nga familja.

Grupi i punës konstaton se megjithëse skema e përgjithshme mbi ribursimin e medikamenteve funksiononte normalisht, të burgosurit në varësi të kërkesave të tyre për tituj të ndryshme medikamenteve të cilat ishin jashtë kësaj skeme të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë ata ishin të detyruar të drejtoheshin familjereve të tyre me kërkesa të ndrrshme sipas nevojave të tyre.

Nga biseda me të dënuarit/paraburgosurit, u konstatuan se kishte ankesa të shumta për shërbimin stomatologjik, i cili ishte pjesërisht funksional për arsye se në institucion kishte mjek stomatolog me kohë të pjesëshme.

Lista e të sëmurëve përbëhej nga 16 të sëmurë kronik, 1 i sëmurë me diabet si dhe 10 persona të sëmurë të shëndetit mendor, të cilët trajtoheshin me medikamente, ushqim dhe vizita mjeksore sipas rekomandimeve të mjekëve specialist.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Berat, nuk kishte Sektor të Kujdesit të Veçantë në një kohë që për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor duhet të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë, ndaj higjinës vetjake të tyre, si dhe të mjedisit që i rrethon.

Personat të cilët vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, për shkak të sëmundjes së tyre, kanë nevojë për një vëmendje të veçantë, veçanërisht nga ekipi multidisiplinar i institucionit, siç parashikohet në pikën 4 të nenit 3 të ligjit 44/2012, “Për Shëndetin mendor”, i ndryshuar ku thuhet se: "Ekipet multidisiplinare" janë ekipet e përbëra nga specialistë të disa fushave, si mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë, terapistë okupacionalë, logopedistë, terapistë zhvillimi apo specialistë të tjerë, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas protokolleve përkatëse për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit mendor.¹¹

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës”.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për eliminimin e mbipopullimit në IEVP Berat, pasi kjo situatë ka sjellë për pasojë shkeljen e të drejtave jetike të personave të paraburgosur që vuajnë dënimin në këtë institucion, si dhe përbën shkelje të standardeve të parashikuara në aktet ligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.
2. Marrjen e masave për të garantuar akomodimin e të dënuarve dhe të të paraburgosurve në mjedise të përshtatshme banimi, duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6m² për dhomat për një person dhe 4m² për person, kur në to sistemohen më shumë banorë.
3. Të merren masat të menjëherëshme për akomodimin e personave të moshës 18-21 vjeç në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualet e sigurisë për këtë kategori.
4. Marrjen e masave të menjëherëshme për krijimin e Sektorit të Kujdesit të Veçantë (SKV), në IEVP Berat.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për hidroizolimimin e tarracës të godinës së banimit, për eliminimin e lagështirës në dhomat e të paraburgosurve dhe në ambientet e përbashkëta të dusheve dhe tualeteve.
6. Marrjen e masave për riparimin në IEVP Berat, të sistemit qendror për ngrohje/ftohjen e ambienteve të brendshme të institucionit, si dhe garantimin në çdo

¹¹Pika 4 të nenit 3, të Ligjit nr. 44/2012 “PËR SHËNDETIN MENDOR”.

kohë të furnizimit me ujë të ngrohtë për mbajtjen e higjienës personale të të paraburgosurëve dhe të ambienteve të përbashkëta, në përshtatje dhe me kushtet klimaterike të zonës.

7. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës të stafit mjekësor të institucionit me mjek të përgjithshëm me kohë të plotë, stomatolog, farmacistit të punësuar me kohë të plotë.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me autoambulancë, për transportin e të sëmurëve në rastet e emergjencave shëndetësore.
9. Marrja e masave të nevojshme për furnizimin me detergjentë dhe pajisje higjieno-sanitare shtesë dhe sipas normativave mujore të burgosurit, për mbajtjen e higjienës dhe pastërtisë personale, dhomave të banimit dhe ambienteve të përbashkëta. Ushtrimin e kontrolleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit, për verifikimin e furnizimit me detergjentë, sipas normativave mujore të burgosurit, si dhe të marrjes së firmave të cilat vërtetojnë marrjen në dorëzim të këtyre materialeve prej tyre.
10. Marrjen e masave për rritjen e pranisë së punonjësve të sektorit juridik dhe sektorit psiko-social në kontakte të përditëshme me personat që vuajnë dënimin në këtë institucion, për dhënien e këshillimeve ligjore dhe sqarimet për zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave që ata mund të paraqesin.
11. Marrjen e masave të menjëhershme për rritjen e numërit të aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale nga sektori psiko-social, me pjesëmarrjen e gjerë të personave të burgosur, që të ndikojnë në formimin dhe riintegrimin e këtyre personave.
12. Marrjen e masave të nevojshme për hapjen e njësisë tregtare për ofrimin e produkteve bazë të domosdoshme për të dënuarit dhe të paraburgosurit në IEVP Berat.
13. Të merren masa të menjëhershme, për shtimin e operatorëve telefonik dhe vënien në punë të tyre, për plotësimin e nevojave të të burgosurve për kryerjen e bisedave telefonike me familjarët e tyre.
14. Të merren masa të menjëhershme për vendosjen në sektorin e protokoll arshivës të institucionit, të një regjistri të veçantë për regjistrimin e kërkesë/ankesave¹² që kanë të burgosurit dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre, si dhe ku të evidentohet marrja në dorëzim e shkresave zyrtare me përgjigje nga institucionet, në lidhje me ankesa e të burgosurve, kur ata ju drejtohen institucioneve qendrore dhe atyre të pavarura.
15. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e një skaneri në ambientet e IEVP Berat për të bërë të mundur kontrollin me efikasitet të ushqimeve për të dënuarit dhe të paraburgosurit.
16. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e palestrës me materiale, si gira, shtanga sipas peshës dhe vegla të tjera që ndihmojnë të paraburgosurit të kalojnë kohë shlodhëse në këtë drejtim.

¹² Neni 58, pika 6 e ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

17. Marrjen e masave të nevojshme për mobilimin me orenditë e nevojshme dhe pajisjen me materiale informuese për të mundësuar realizimin e takimeve mes të dënuarve dhe fëmijëve të mitur të tyre në kuadrin e garantimit të prindërimit në distancë.
18. Të inkurajohet dhe mbështetet grupi i punës me propozimet për ndryshimin e Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë nr.104/5 prot., datë 19.07.2006 dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.205/3 prot., datë 27.07.2006 “*Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit*”.
19. Marrjen e masave për funizimin me ujë në 24 orë në ditë dhe përmirësimin e ujë të pijshëm në IEVP Berat.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

AHMET PRENÇI